

OBJEKTIVAT E OMBUDSMANIT SI MKIRA

Përforcimi i parimit të legjitimitetit dhe parimeve të miradministrimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga organet e vendosjes së rendit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

Neutralizimi i çdo nënteksti në lidhje me investigimin jo efikas të rasteve të arbitraritetit.

Mbrojtja e të drejtave të qytetarëve nga ushtrimi arbitrar dhe i paligjshëm i pushtetit të dhënë organeve shtetërore për kryerjen e detyrave të tyre.

SI BËHET DENONCIMI PËR ARBITRARITET

Denoncimi paraqitet me shkrim.

Në rastin kur denoncuesi nuk njihet gjuhën greke mund të kërkojë ndihmën e përkthyesit.

Në rastin kur denoncuesi nuk mund të shkruajë, denoncimi përpilohet nga një nëpunës i Ombudsmanit.

Denoncimet anonime arkivohen, por mund të shqyrtohen sipas gjykimit të Ombudsmanit në kuadrin e ex officio ndërhyrjes së tij.

- **Me paraqitje personale ose me prokurë** në zyrat e Ombudsmanit, në rrugën Halkokondyli 17, K.P. 10432, Athinë Nga e hëna në të premten, 8:30 – 14:00 dhe të mërkurën 8:30 – 16:30

- **Me letër** postare në adresën e mësipërme.

- **Me fax** te numrat 213 130 68 00.

- **Në mënyrë elektronike** www.synigoros.gr/e-anafora

KONTAKTONI ME OMBUDSMANIN GREK

Me telefon

213 130 66 00

Nga e hëna deri të premten 8:30-14:00

Me faks

213 130 68 00

Me post

Rruga Halkokondyli 17
GR-10432, Athinë

Online

www.synigoros.gr

Të mërkurën
8:30-16:30





The Ombudsman / The Greek Ombudsman



@Synigoros

MEKANIZMI KOMBËTAR I INVESTIGIMIT TË RASTEVE TË ARBITRARITETIT



THE GREEK
OMBUDSMAN
INDEPENDENT AUTHORITY

OMBUDSMANI si MEKANIZMI KOMBËTAR I INVESTIGIMIT TË RASTEVE TË ARBITRARITETIT (MKIRA) **investigon raste e arbitraritetit gjatë ushtrimit të detyrave ose shpërdorimit të kompetencave të organeve të vendosjes së rendit.**

CILËT KONTROLLON

Personelin me uniformë të:

- Policisë Greke
- Korpusit Bregdetar – Truprojes Bregdetare
- Shërbimin Zjarrfikës

Si edhe nëpunësit e:

- Qendrave të paraburgimit

ÇFARË KONTROLLON

- Akte që përbëjnë tortura dhe fyerje të tjera të dinjitetit njerëzor në kuptimin e nenit 137 A të Kodit Penal.
- Fyerje të qëllimshme ndaj jetës e sovranitetit trupor ose shëndetit ose lirisë personale dhe seksuale.
- Përdorim të paligjshëm të armës së zjarrit.
- Sjellje të paligjshme për të cilët ekzistojnë indekse të stimulit racor që konsiston në tjetër lloj trajtimi diskriminues për shkak të tipareve të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare ose etnike, prejardhjes gjenetike, invaliditetit, orientimit seksual, identitetit ose karakteristikave të seksit.

SI NDËRHYN

- Pas denoncimeve me emër.
- Ex officio pas një denoncimi anonim, artikulli në shtyp, apo delegimi të çështjes nga Ministri ose Sekretari i Përgjithshëm kompetent.

OMBUDSMANI SI MKIRA

- **Mbikqyr** investigimin efikas dhe të plotë të çdo rasti arbitrarireti.
- **Operon paralelisht** me organet kompetente disiplinore.
- **Ndjek** evoluimin e procesit disiplinor.
- Kur gjykon se një çështje disiplinore nuk është shqyrtuar në thellësi ose konstaton se gjatë shqyrtimit të saj u bënë gabime procedurale ose dhe lapsuse mund të kërkojë përpilimin e konkluzionit në fjalë.
- Mundet që të **investigojë vetë** raste arbitrariteti.
- **Organet kompetente** disiplinore pezullojnë daljen e vendimit deri në komunikimin e konkluzionit të Ombudsmanit.

- Përkujdeset për informimin e organeve kompetente gjyqësore në rastin kur konstaton kryerjen e veprimeve penalisht të dënueshme.
- Merr përsipër çështje për të cilat ka dalë vendim dënimi nga ana e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe mund të urdhërojë rishqyrtimin administrativ-disiplinor të çështjes.
- Nuk **zëvendëson** kontrollin gjyqësor dhe disiplinor të rasteve të arbitraritetit.
- Nuk **përfaqëson** viktimën në gjykatë dhe nuk akordon dëmshpërblime.

MKIRA përbën kompetencë të veçantë të Ombudsmanit dhe është pjesë integrale e strukturës së tij nga ana funksionale dhe organizative. Ushtrimi i kompetencës rregullohet nga dispozitat e nenit 56 të L. 4443/2016 dhe Rregullores së Funksionimit që u përpilua me vendim të Ombudsmanit (FI10/24727/2017, FEK B 2065).